



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media
Mbledhja nr. 7
Prishtinë, më 13 maj 2008, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buçinca, Hajdin Abazi, Melihate Tërmkollli, Anita Morina, Rasim Selmanaj, Synavere Rysha, Radmila Vujovic, Ali Lajçi.

Të pranishëm:

Nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Drita Morina – zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri
Nga-NDI:

Mbledhjen e kryesoi z. **Esat Brajshori**, kryetar i Komisionit, i cili propozoi këtë

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Miratimi i rekomandimit për Projektligjin për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. L – 054/1.
3. Shqyrtimi i raportit të vizitave të Komisionit në terren gjatë vitit 2007 dhe planifikimi i vizitave për vitin 2008.
4. Diskutim për monitorimin e ligjeve.
5. Shqyrtimi i shkresës së televizioneve rajonale të Kosovës.
6. Të ndryshme.

Melihate Tërmkollli tha se nuk është mirë që në rendin e ditës të jenë të propozuara shtatë deri në tetë pika të natyrave të ndryshme. Ajo propozoi që të bëhet një klasifikim me qëllim që çështjet të trajtohen në mënyrë esenciale.

Rendi i ditës u miratua pa plotësime.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i rekomandimit për Projektligjin për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. L – 054/1.

Kryetari-Tha se Projektligji për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. L–054 është shqyrtuar dhe amendamentuar nga Komisioni në mbledhjen e mbajtur me datë 25.04.2008, ndërsa Amendamentet 5,6,7 ,pas konsultimeve , janë harmonizuar me ligjet tjera .

Kryetari konstatoi se unanimisht u miratua Rekomandimi për Projektligjin për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr. L – 054/1.

3. Shqyrtimi i raportit të vizitave në terren gjatë vitit 2007 dhe planifikimi i vizitave të komisionit për vitin 2008.

Kryetari- Njoftoi Komisionin për vizitat që Komisioni në mandatin e kaluar ka realizuar në disa Komuna të Kosovës dhe propozoi që Komisioni të vazhdojë me vizitat duke u përcaktuar se cilën nga Komunat e Kosovës, Komisioni, do të vizitojë në vazhdim. Lidhur me këtë, ai tha ,se Komisioni ka pranuar edhe dokumentet nga OSBE- ja e që janë:

- Raportin mbi themelimin e degës ekzekutive komunale në bazë të Rregullores së UNMIK ut nr. 2007/30,
- Marrëdhëniet ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale në Kosovë,
- Udhërrëfyes për statutet Komunale.

Hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Fehmi Mujota- Tha se qëllimi i vizitave në komuna bëhet me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve dhe për tu njoftuar me problemet që komunat kanë në zbatimin e tyre. Ai propozoi që Komisioni të përcaktohet për një ose dy ligje, të cilat janë për tu monitoruar dhe pastaj të punohet raporti i cili do të ishte një ndihmesë e madhe për të parë se sa zbatohen ligjet.

Një prej ligjeve për të cilin do të kërkohet të jemi më aktiv është ligji për përdorimin e gjuhëve në Kosovë ,andaj, është mirë që Ligji në fjalë të përfshihet në agjendën e Komisionit për monitorim. Vizitat duhet të përgatiten ashtu që Komisioni të jetë konkret dhe të kërkojë nga komunat që përveç njoftimeve për problemet ato të paraqesin edhe me shkrim,ne forme raporti, problemet që tregojnë nivelin e zbatimit të ligjit perkates.

Melihate Tërmkoll- Tha se asnjë ligj i miratuar nuk detyron ekskluzivisht zbatimin e tyre vetëm nga komunat. Ajo propozoi që nëse parashihet plani i komisionit për vizita lidhur me mbikëqyrjen e ligjeve atëherë në këtë plan të përfshihen edhe institucionet e nivelit qendror si dhe institucionet e tjera publike, natyrisht me theks të veçantë ato të cilat bien në fusheveprimtarinë e Komisionit. Esenciale është se çfarë duam të arrijmë me këto vizita, pra këto vizita të përqendrohen edhe në planin esencial e jo të mbesin vetëm në planin formal.

Sipas saj, Komisioni është dashur të ketë një plan se në çfarë mënyre do të bëjë monitorimin e ligjeve .Duke propozuar që kjo çështje të mbetet për mbledhjen e ardhshme , ajo tha, duhet të hartohet një plan konkret ,komisioni të shqyrtojë atë plan,e pastaj të bëjmë orientimet se si do të jenë prioritetet e Komisionit në monitorimin e ligjeve.

Hajdin Abazi -Tha se nga raporti mandator i punës së këtij Komisioni kam vërejtur se në mandatin e kaluar disa komuna nuk janë vizituar fare nga ky komision. Ai propozoi që në radhë të parë Komisioni të planifikojë se cilat komuna do t'i vizitoje, e pastaj të vendos se si ta realizojë atë vizitë edhe në institucionet qëndrore.

Shpresa Murati-Tha se përveç komunave që janë evidencuar e të cilat komisioni nuk i ka vizituar është edhe komuna e Dragashit. Ajo propozoi që të vizitohet edhe kjo komunë.

Gani Buçinca –Tha se roli i deputetit është të aprovoi ligje dhe të mbikëqyr implementimin e tyre. Komisioni duhet të planifikoi orarin e vizitave në të cilin do të përcaktoi se pse bëhet ajo vizitë, për cilin ligj konkret, në mënyrë që të marrim informacione nëse po implementohen ose jo ato ligje.

Synavere Rysha- Tha se vizitat në teren janë të nevojshme, por çështja e parë që duhet të merret parasysh është se cilat ligje do t'i monitorojë Komisioni dhe që Komunat të njoftohet paraprakisht për atë vizitë, në mënyrë që ai takim të jetë i suksesshëm. Nuk është e rëndësishme se cilën komunë Komisioni vendos të vizitojë, por është e rëndësishme të arrihet qëllimi i vizitës.

Propozoi që kjo çështje të mbetet për mbledhjen e ardhshme, të hartohet një planë konkret dhe komisioni të shqyrtoj atë plan.

Pas diskutimeve të deputetëve lidhur me pikën e tretë të rendit të ditës komisioni nxori këtë

Përfundim

-Të hartohet itinerari i vizitave të komisionit nëpër komuna.

-Të përcaktohen ligjet të cilat Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media do t'i monitoroi.

4 Diskutim për monitorimin e ligjeve.

Pika e katërt e rendit të ditës është shtyer për mbledhjen e ardhshme, pasi që është e ndërlidhur me pikën e tretë të rendit të ditës.

5 Shqyrtimi i shkresës së televizioneve rajonale të Kosovës.

Kryetari- Tha se Komisioni ka pranuar një shkresë nga televizionet rajonale të Kosovës ku kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin. Ai ishte i mendimit se këtë shkresë Komisioni duhet t'ia dorëzoje Qeverisë së Kosovës si sponzoruese e ligjit. Hapi diskutimin lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Fehmi Mujota-Propozoi që Komisioni të organizojë një dëgjim publik lidhur me këtë çështje në mënyrë që të mund të identifikojmë problemet dhe nese Komisioni vlerëson nevojën për plotësim ndryshimet e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin atëherë janë të mirëseardhura të gjitha propozimet, qofte nga anëtarët e Komisionit, nga mediumet, apo edhe nga shoqëria civile. Ai tha, kjo është një fazë e hershme që Komisioni të vendos për t'ju dhënë apo jo përkrahje parashtruesve të kësaj shkrese.

Ai tha se shkresa nga televizionet rajonale të Kosovës në këtë fazë duhet të trajtohet si një iniciativë e mirë për të bërë një konsultim më të gjerë lidhur me plotësim ndryshimet e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin.

Hajdin Abazi- Tha se Komisioni duhet të ketë një qëndrim lidhur me propozimin e televizioneve rajonale të Kosovës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin duke konsiduar të paarsyeshëm propozimin që kjo shkresë t'i drejtohet sponzoruesit.

Gani Buçinca- Duke theksuar domosdoshmërinë për ndryshimin e ligjit, propozimi i tij ishte që Komisioni duhet të ketë një qëndrim lidhur me këtë, ai tha, në momentin kur Komisioni do të fillojë me procedurën e ndryshimit të ligjit do të kemi parasysh propozimet e radio televizioneve të cilat ia kanë adresuar Komisionit. Kjo do të ishte mënyra se si ne duhet t'i përgjigjemi parashtruesve të kësaj shkrese.

Melihate Tërmkollli –Tha se shkresa nga televizionet rajonale të Kosovës ku kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin, është një iniciativë e mirë, propozimi i saj ishte që implementimi i Ligjit në fjalë së pari të debatohet, pastaj Komisioni të merr iniciativën për zhvillimin e procedurës së mëtejshme.

Pas diskutimeve të deputetëve lidhur me pikën e pestë të rendit të ditës Komisioni nxori këtë :

Përfundim

Te organizohet një dëgjim publik lidhur me Ligjin për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Transmetimin.

6. Të ndryshme

Gani Buçinca – Tha se në institucionin e RTK-së dhe të KPM-së është një kaos i madh. Këto institucione nuk funksionojnë ligjërisht. RTK-ja ka një bord, drejtor dhe menaxhment, jo legjitim, të cilit i ka skaduar mandati. Për të fituar legjitimitetin këto organe duhet të funksionojë KPM-ja dhe kjo është pasojë e neglizhencës së këtij Komisioni dhe të Kuvendit në përgjithësi. Kërkesa e tij ishte që Komisioni sa më parë të merret me këto dy institucione dhe propozoi që Komisioni të vizitoi KPM-në, para se të realizohet vizita në komuna.

Synavere Rysha -Propozoi që si prioritete të Komisionit për monitorim të ligjeve jenë Ligji për KPM-në dhe Ligji për RTK-në. Ajo tha, deri më tani Kuvendi nuk ka shqyrtuar asnjë raport të asnjë institucioni. Këto institucione janë duke vepruar në kundërshtim me të gjitha rregulloret.

Kryetari- Tha se Ligji për KPM-në dhe Ligji për RTK-në do të shqyrtohen nga ky Komision dhe do të vlerësohet nevoja e ndryshim plotësimi të këtyre Ligjeve.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 11:19

Përgatitur nga

Zyra kordinuese e Komisionit

Esat Brajshori